



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 5
Prishtinë, më 16 nëntor 2017, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-1-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Verica Çaraniq, Faton Topalli, Shqipe Pantina, Avdullah Hoti, Albert Kinolli, Mërgim Lushtaku, Andin Hoti, Blerim Kuçi dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Ali Lajçi

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj dhe Mehmet Simnica.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Besnik Osmani, auditori i Përgjithshëm, Qendresa Mulaj dhe Imri Semetishti, nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 9.11.2017;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Raportit të Pasqyrave Financiare të audituara për vitin 2016;
4. Shqyrtimi i planit vjetor të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit, për sezonin e Auditimit 2017/2018;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 9.11.2017;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 9.11.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Raportit të Pasqyrave Financiare të audituara për vitin 2016;

Driton Selmanaj, kryetar, theksoi se bazuar në Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 14 pika 2, ku thuhet „brenda katër (4) muajve nga përfundimi i vitit buxhetor, Auditori i Përgjithshëm i dorëzon Kuvendit Raportin Vjetor të Performancës, rreth aktiviteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Ky raport përfshin ekstraktet relevante nga Pasqyrat Vjetore Financiare si dhe opinionin e Auditimit të dhënë nga auditorët e pavarur”. PVF-2016 të ZKA-së janë audituar nga kompania private e auditimit „Grant Thornton” (e emëruar nga Kuvendi për një periudhë të Auditimit prej tri vitesh). Sipas këtij auditimi del se PVF-të e prezantuara të Zyrës Kombëtare të Auditimit, paraqesin një pamje të drejt dhe reale. Pavarësisht kësaj, auditori i jashtëm në letërën e menxhmentit, ka paraqitur edhe disa dobësi, të cilat nuk kanë pasur ndikim material si dosjet e personelit, trajtimi i borxheve, Shpenzimet (Mallrat dhe Shërbimet).

Auditori ka identifikuar se në disa raste asnjë nga kontratat nuk është vëlosur nga kontraktuesi i autoritetit, ashtu siç kërkohet me Ligjin Nr. 04 / L042. Për më shumë, gjatë auditimit tonë, kemi vërejtur tre raste, kur faturat për shpenzimet e bëra nga Organizata nuk janë protokolluar dhe regjistruar në librin e faturave siç kërkohet nga neni 24 i Rregullës Financiare Nr. 01/2013 / MF - Shpenzimet e Fondeve Publike. Prokurimi- asnjë nga marrëveshjet e prokurimit nuk ishin të vëlosura nga Zyra Kombëtare e Auditimit (si autoriteti kontraktues), ka pasur vetëm nënshkrime. Stoket- bazuar në listën e stokeve të siguruar, Auditori ka identifikuar që karburanti nuk është paraqitur në listë dhe nuk ka raport të numërimit për karburantin e ngrohjes qendrore dhe gjeneratorit.

Numërimi i inventarit në fund të vitit nuk u barazua me listën e inventarit. Një dukuri tjetër e paraqitur në këtë raport, është edhe shkalla e implementimit të rekomandimeve nga viti paraprak. Edhe këtu vërehet se ka përparim, si në reduktimin e shpenzimeve të telefonit të stafit, mbajtja e dosjes së personelit, rekrutimi i stafit etj. Me këtë hapi diskutimin.

Besnik Osmani, Auditori i Përgjithshëm, paraqiti para Komisionit të arriturat dhe sfidat e Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016. Sipas këtij raporti, shihet se Orientimi i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016 ishte në rritjen e cilësisë dhe numrit të auditimeve të rregullsisë dhe të performancës; në finalizimin e legjislacionit sekondar; në ngritjen dhe forcimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të brendshme; në thellimin e bashkëpunimit me Kuvendin; shoqërinë civile; intensifikimin e bashkëpunimit me ISA-të tjera dhe përgatitjet për procesin e anëtarësimit në organizatat rajonale e ndërkombëtare të ISA-ve.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri, Auditori i Përgjithshëm me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore, filloi me hartimin e rregulloreve të brendshme për të përcaktuar organizimin dhe menaxhimin e brendshëm të ZKA-së. Gjatë periudhës raportuese janë hartuar dhe aprovuar: Rregullorja për Marrëdhënie Pune, Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ZKA, Udhëzimin Administrativ për Zbatimin e të Drejtave dhe Përgjegjësisë të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Entiteteve të Audituar, etj.

Po ashtu, gjatë pjesës së parë të vitit 2016, ZKA-në e karakterizon një punë intensive e përfundimit të auditimeve të rregullsisë për vitin 2015. ZKA-ja ka publikuar 91 raporte të auditimit të rregullsisë, pesë raporte të auditimit të performancës dhe dy raporte auditimi të projekteve të financuara nga donatorët. Detajet për këto raporte janë të paraqitura më poshtë në këtë raport. Deri në fund të vitit 2016, ZKA-ja ka përfunduar dhe publikuar: Raportin Vjetor të Auditimit të Buxhetit të Kosovës, për vitin 2015; 90 raporte të auditimit të rregullsisë, për vitin 2015; 5 raporte të auditimit të performancës.

Përmes auditimit të rregullsisë ZKA-ja ka arritur ti mbulojë të gjitha OB-të me përjashtim të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. Numri i auditimeve të rregullsisë dhe të performancës është duke u rritur, ndërsa presim që ZKA-ja të auditojë më shumë projekte të financuara nga donatorët dhe huamarrja në të ardhmen.

Faton Topalli, tha se bazuar në të dhënat e paraqitura në këtë raport, shihet se ka përparim, në numrin e auditimeve, cilësinë e raporteve të auditimit etj. Po ashtu, pyeti se bazuar në rekomandimet e dhëna nga viti i kaluar, ku është thënë se ZKA-ja të këtë bashkëpunim me sektorin e drejtësisë për të hetuar rastet e shkeljeve të mundshme materiale, megjithatë askund në raport nuk është paraqitur ndonjë e dhënë e tillë, cili është mendimi i juaj për këtë?

Shqipe Pantina, theksoi se nga raportet e paraqitura deri tani në Komision, ky është njeri prej raporteve më të mira të elaboruara me të dhëna dhe fakte, kur dihet se ky institucion si dhe pozita e Auditorit të Përgjithshëm deri vonë është udhëhequr nga Bashkimi Evropian. Në raport është paraqitur se 6 komuna dhe një Ministri PVF-të e tyre janë audituar nga një operator ekonomik e jo nga ZKA-ja, cili kriter është përzgjedhur nga ZKA-ja për të caktuar komunat për këtë operator ekonomik?

Po ashtu, sa i përket auditimit të jashtëm për PVF-të e ZKA-së, të gjeturat janë më se normale. E gjetura e përsëritur është sa i përket dosjes së personelit. Pantina pyeti se a mundet ZKA-ja t'ju ndihmojë Agjencive të Pavarura se si të përgatiten raportet vjetore të punës, me qëllim që këto raporte të jenë të pranueshme dhe të kuptueshme për Kuvendin dhe për publikun?

Zafir Berisha, theksoi se raporti si i tillë dhe paraqitja e Auditorit të Përgjithshëm ishte reale. Kjo pasqyron gjendjen reale të financave publike në Kosovë. Ndikimi politik dhe ndikimi i menxhmentit mbi auditorët paraqet një rrezik për mosprezantim real të fakteve në raportet e auditimit të brendshëm po edhe atij të jashtëm. Cilat janë pengesat ligjore që ka ZKA-ja në arritjen e objektivave? Cili është bashkëpunimi i ZKA-së me organet e hetuesisë dhe drejtësisë?

Blerim Kuqi, theksoi se numri i auditimeve është në rritje për 17% nga viti paraprak. Sa është transparenca e juaj me institucionet e interesuara për raportet e auditimit? Përveç ueb faqes së juaj, ku të interesuarit mund ti gjejnë raportet e auditimit, sa është transparenca juaj në takimet me shoqërinë civile dhe dëgjimet publike, ku prezanton ZKA-ja?

Mërgim Lushtaku, theksoi se raporti i performancës së ZKA-së për vitin 2016, është raport cilësor me pasqyrim të saktë të punës së ZKA-së, arritjen e objektivave si dhe sfidat e këtij institucioni. Po ashtu, tha se do të rekomandoja që ZKA-ja të bëjë auditim të Ndërmarrjes Publike (KEK) si dhe të bëjë auditim të Sistemit të Shërbimit Civil, në veçanti mënyrën se si Institucionet po bëjnë avancimin e stafit. Gjithashtu është e rëndësishme të shikohet nga ZKA-ja se me rastin e skadimit të mandateve të ministrave dhe zv. Ministrave, këshilltarët dhe stafit mbështetës po mbesin në punë pa ndonjë kriter të rregullt të punësimit.

Avdullah Hoti, theksoi se bazuar në planin e punës së ZKA-së për sezonin e auditimit 2017-2018, të paraqitur në Komision, vërehet se ka një plan mjaft ambicioz. Me qëllim të realizimit

të këtij plani ZKA-së mendoj se do ti duhet mbështetje financiare, për të cilën ne si Komision duhet të kërkojmë nga Komisioni i Buxhetit, që në projektbuxhetin e vitit 2018-2020 ta mbështetë ZKA-në financiarisht. Po ashtu, nëse ka hapësirë në planin e auditimit për sezonin e ri të auditimit, Komisioni, mendoj duhet të propozojë për auditime të performancës.

Besnik Osmani, Auditori i Përgjithshëm, u përgjigj në të gjitha pyetje e parashtruara nga deputetë e Komisionit, po ashtu, ai shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar me KMFP-në, po edhe me komisionet parlamentare të tjera të Kuvendit, me qëllim arritjes së objektivave të përbashkëta për një menaxhim sa më të mirë të parasë publike.

Driton Selmani, kryetar, pas përfundimit të diskutimeve, propozoi që të votohet për raportin e performancës së ZKA-së për vitin 2016, së bashku me këto rekomandime: Zyra Kombëtare e Auditimit, gjatë auditimeve për sezonin e auditimit 2017-2018, të fokusohet në rekomandimet e dhëna nga auditori i brendshëm dhe sa ato rekomandime po zbatohen nga menaxhmenti i institucioneve. Zyra Kombëtare e Auditimit të rritë numrin e raporteve të performancës, e veçanërisht për ndërmarrjet publike. Gjatë auditimeve të ndërmjetme, Zyra Kombëtare e Auditimit të mbikëqyrë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga viti paraprak.

Përfundim:

KMFP-ja, miratoi Raportin e performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016, së bashku me rekomandimet e Komisionit dhe të njëjtin do ti adresojë për në seancë plenare për shqyrtim dhe miratim.

4. Shqyrtimi i planit vjetor të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit, për sezonin e Auditimit 2017/2018;

Driton Selmani , kryetar, njoftoi deputetët se ZKA-ja ka dorëzuar planin e auditimit për sezonin e auditimit 2017/2018, me një plan detal të auditimeve, që do të pasojnë gjatë kësaj kohe. Andaj, nëse Komisioni ka kërkesa për të plotësuar këtë plan, këtë mund ta bëjmë tani.

Faton Topalli, pyeti se në bazën ligjore ekzistuese mbi të cilin funksionon ZKA-ja, a ekziston mundësia që të bëhet auditim i mënyrës së dhënies me koncesion të Aeroportit, mënyra e Privatizimit të Distribucionit të Energjisë Elektrike, mënyra e përzgjedhjes së operatorit ekonomik për autostradat etj?

Shqipe Pantina, theksoi se është mirë, meqenëse po diskutojnë për ZKA-në dhe punën e saj për sfidat me të cilat është ballafaquar, planin për sezonin e ri të auditimit 2017/2018. Që ta kemi më të lehtë përmbushjen e objektivave, të bëjmë një rekomandim për sigurimin e buxhetit të mjaftueshëm që ZKA-ja të mund të sigurojë hapësira pune dhe një komoditet më të madh në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi.

Besnik Osmani, Auditori i Përgjithshëm, u përgjigj në pyetjet e parashtruara, duke theksuar se ZKA-ja do të bëjë auditim për mënyrën e shpenzimit të parasë publike edhe për ndërmarrjet publike për të cilat ekziston baza ligjore.

Kryetari, propozoi që nëse kemi propozime konkrete për auditime shtesë e të cilat nuk janë paraqitur nga ZKA-ja në planin e auditimit për sezonin e auditimit 2017/2018, ti përgatisim ato dhe në mbledhjen e radhës të KMFP-së, t'i propozojmë si rekomandime për ZKA-në.

Përfundim:

KMFP-ja, vendosi që aprovimin final të planit vjetor të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit, për sezonin e Auditimit 2017/2018, ta bëjë në mbledhjen e radhës së Komisionit, pasi Komisioni ti ketë rekomandimet shtesë.

5. Të ndryshme.

Driton Selmani, kryetar i njoftoi deputetët se në Komision është proceduar Projektligji për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, dhe ne si komision pa humbur kohë duhet ta trajtojmë në mbledhjen e radhës së komisionit për në lexim të parë.

Po ashtu, nga grupi për Studime Juridike dhe Politike, jam i njoftuar se Ligji për Financimin e Subjekteve Politike është në procedurë për ndryshim dhe plotësim. Andaj, me qellim që të kemi njohuri se si është e rregulluar mënyra e auditimit të raporteve financiare të subjekteve politike në vendet e rajonit. Kërkojmë nga Drejtoria e Hulumtimeve brenda Kuvendit të bëjë një analizë për mënyrën e Auditimit të raporteve financiare të subjekteve politike në rajon dhe Komisionit, dhe për këtë ti prezantohet ky raport.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Driton Selmanaj